



KOMUNA E PRISHTINËS

MUNICIPALITY OF PRISHTINA - OPŠTINA PRISTINA

HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Komiteti Konsultativ

RAPORT 1

DATA: 08/09/2022

VENDI: KOMUNA E VJETËR




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I.** Miratohet vendimi për formimin e Komitetit konsultativ për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale.
- II.** Anëtarë të Komitetit konsultativ sipas pikës I të këtij vendimi janë:
 - **Drejtoria e Planifikimit Strategjik:**
 1. Mimoza Sylejmani, kryesuese.
 - **Drejtoria e Urbanizmit:**
 2. Arbër Sadiki.
 - **Asociacioni i arkitektëve të Kosovës;**
 3. Arch. Masar Dushi.
 - **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;**
 4. Edona Durguti.
 - **Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa kufinj (CHwB):**
 5. Nol Binakaj.
 - **UN Habitat Kosova:**
 6. Besnike Koçani.

- **Instituti për Planifikim Hapësinor:**

7. Luan Nushi.

- **NGO Pro-Planning:**

8. Lumnie Gashi – Shabani,

- **Fakulteti i Arkitekturës:**

9. Prof.Ass.Dr. Ardita Byci Jakupi.

- **Klubi i Prodhuesve të Kosovës::**

10. Astrit Panxha.

III. Detyrat e Komitetit konsultativ janë:

1. Dhënia e mendimit profesional për çështjet që trajtohen në grupin punues për hartim të PZHK-së dhe HZK-së.
2. Ky komitet duhet ti jap me shkrim sugjerimet e tyre lidhur me çështjet që diskutohen.
3. Para dërgimit në MMPH dhe Kuvend, Komiteti Konsultativ do të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të dokumentit final dhe do ti rekomandoj Kryetarit të Komunës procedimin e Planit për Miratim.

IV. Për kryerjen e punëve, komiteti konsultativ do ti raportojë Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS

Përparim Rama





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Komiteti për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale

Datë: 08.09.2022

Nr	Emri dhe Mbiemri	E-mail dhe tel.	Nënshkrimi
1	MASAR DASHI	masar.dashi@gmail.com	
2	ARITA BYCI JARUJ	arita.byci@uni-pr.edu	
3	NOL BINAKAJ	nbinakaj@gmail.com	
4	AIDA DOBUNA	aida.dobuna@gmail.com	
5	SADIJE DELIU	sadijed@gmail.com	
6	EDONA DURGUTI	edona.durguti@rks-gov.net	
7	SAFI DURAHA	sduraha@rks-gov.net	
8	IDRIZ SHALA	idriz.shala@gmail.com	
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Komiteti për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale

Datë: 08.09.2022

Nr	Emri dhe Mbiemri	E-mail dhe tel.	Nënshkrimi
1	SAMI STAGOVA	sami.stagova@un.org 044 368 340	
2	LUAN NUSHI	luan.nushi@rks-gov.net	
3	ARBËR SADIQI	arbar.sadiki@rks-gov.net	
4	MIMOZA SYLEJMANI	mimoza.sylejmani@rks-gov.net	
5	AFËRDITA GASHI SIMANAJ	afendita.gashi.simanaj@rks-gov.net	
6	LYRA BAKIJA	lyrabak@gmail.com	
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			

KOMITETI PËR PLANIN ZHVILLOR KOMUNAL DHE HARTËN ZONALE

PJESËMARRES NË TAKIM:

1. Perparim Rama
2. Vllaznim Osmani
3. Alban Zogaj
4. Mimoza Sylejmani
5. Arber Sadiki
6. Aferdita Sinanaj
7. Lyra Bakija
8. Luan Nushi
9. Masar Dushi
10. Ardita Byci Jakupi
11. Nol Binakaj
12. Aida Dobruba
13. Sadije Deliu
14. Edona Durguti
15. Sami Duraku
16. Idriz Shala
17. Sami Stagova
18. Qendrim Gashi

PROCES VERBALI

Lyra BAKIJA: fillon me prezantimin duke i përshëndet të gjithë të pranishmit në sallë, dhe thotë se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal, pasi që të gjithë jeni ekspert në këtë fushë nuk po hi në detaje, i dimë krejt specifikisht çka përmban plani, për momentin jemi në fazën ku e kemi bërë profilin komunal, analizat dhe vlerësimin e gjendjes prej profilit komunal, prej nga kanë dal edhe sfidat dhe nevojat zhvillimore për ato tematika që trajtohen në planin zhvillimor komunal. Si grup punues e kemi përcaktuar vizionin, qëllimet dhe objektivat prej krejt anëtarëve të grupit punues duke përfshi edhe drejtorët e sektorëve relevant, edhe kemi dal me disa skenarë ku kemi rënë dakord në njëfarë forme për njërin nga skenarët që do ta prezantojmë për pak, jemi në fazën e konceptit të zhvillimit hapësinor që trajtohen sektor pas sektori.

Mimoza SYLEJMANI- shton duke thënë që ne qeverisjen e kaluar ,dokumenti dy here është dërguar ne Ministrinë e Planifikimit, ku janë dhënë disa komente për dokumentin, ne natyrisht nuk i kemi kthyer përgjigje Ministrisë por kemi reduktuar aq shume gjëra , ju shumica e dini se keni qenë në grupin punues, e dini që ka pas gjëra të kopjuara prej Komunave tjera, dokumenti ka qenë 693 faqe, për atë edhe jemi vonuar në këtë pjesën që tani Lyra do ta prezantoj.

Vullnet OSMANI- vazhdon duke thënë që kur e kanë marrë dokumentin kanë dashtë më qenë sa më pak paragjykes, dhe çka ka elemente të mira me i mbajt , çka nuk janë të hiqen, dhe thotë që ne nuk kemi trashëguar një dokument në formatin e duhur, në kuptimin e të dhënave të GIS, se është e palogjikshme të vazhdohet me një dokument në këtë kohë pa i pas të dhënat me aspektin e GIS, gjithashtu shton se tani Komuna e Prishtinës është e pajisur me licencë dhe e kemi softuerin siç duhet.

Lyra BAKIJA- vazhdon duke shtuar se ka pas shume probleme në tekstin ekzistues dhe prej 693 faqeve, sa i përket redaktimit të profilit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese kemi një dokument me 200 e diçka faqe dhe krejt të dhënat që kanë mbet në dokumentin që jemi duke punuar janë të bazuara në udhëzimin administrativ për elementet, zbatimin dhe hartimin e PZHK-së. Shumica e të dhënave të sakta kane mbete siç kanë qenë, e shumica kanë qenë pa burime, nuk kanë pas referenca, dhe kjo në aspektin profesional nuk na lejon më i përdor ato të dhëna si të mirëqena, por jemi munduar t'i gjejmë prej Institucioneve përkatëse për ta plotësuar në mënyrën e duhur dokumentin. Këto janë fushat tematike të cilat veç i dimë, të cilat varen prej demografisë dhe projeksionit të popullsisë për 8 vitet e ardhshme, që mbetet problemi kryesor në Komunën e Prishtinës duke marrë parasysh dinamikën si janë, që kemi shumë banorë që nuk janë të regjistruar dhe ka shumë lëvizje, por jemi duke u munduar ta gjejmë një mesatare, një vlerësim sa më të saktë të cilin kemi me e marre për baze për zhvillimet e tjera. Projeksioni real i numrit të popullsisë na duhet gjithsesi, e kemi vlerësimin e popullsisë sipas ASK-së , popullsia e banueshme është pak me lehtë , popullsia jo e banueshme është problemi kryesor, mandej të zhvillimi ekonomik merren parasysh ekonomitë familjare, punësimi, papunësia, sektorët kryesor ekonomik që e përfshinë bujqësinë, industrinë dhe sidomos turizmin. Gjithashtu janë edhe zonat ekonomike të cilat në Komunë të Prishtinës janë më shume si korridore se sa si zona. Te infrastruktura e kemi ujësjellësin , kanalizimin edhe në zonën urbane edhe në zonën rurale, energjinë elektrike, ndriçimin publik që është shumë me rëndësi, infrastrukturën e transportit. Kemi pak probleme me trashëgiminë natyrore, kemi të dhëna edhe për ndotjen e mjedisit, i kemi edhe asetet turistike, kemi probleme me vendbanimet joformale.

Ardita BYCI-shton që dëshiron të dije se a kane mbërri ta sigurojnë se sa është sipërfaqja e Komunës së Prishtinës, se është informatë shumë me rëndësi sepse lidhet me krejt fushat tematike. A ka ndonjë dokument që është lëshuar nga Ministria.

Lyra Bakija- thotë se e kanë një me matjet e vitit 2018.

Vllaznim Osmani-vazhdon duke thënë se e kanë si problem vendbanimet joformale se në dokumentin ekzistues nuk ka pas asnjë vendbanim joformal në Komunën e Prishtinës, dhe shtoi që së bashku këtu ti mbledhim të gjitha informatat që të dalim me një informatë sa më të saktë. Përveç kësaj ne i kemi edhe tre sfida tjera, 1)Plani Hapësinor i Kosovës është dashtë të rishqyrtohet, i ka skaduar afati, 2) Regjistrimi i saktë i popullsisë dhe 3) Presioni i madh nga publiku për dokumentin i cili është ndal për arsye, e tani ne po e vazhdojmë sepse nuk mundemi me prit, edhe së bashku duhet të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet relevante për ta bërë një dokument sa ma të mirëfilltë dhe të saktë.

Aida Dobruna- shton qe është edhe një raport i para 10 apo 12 viteve i lëshuar nga Ministria

Masar Dushi- thotë se sipas analizave të mobilitetit janë rreth 170 mijë vetura që hyjnë brenda ditës ne Prishtinë.

Lyra Bakija- vazhdon duke thënë që prej komenteve të Ministrisë që i kemi marrë, thotë që duhet të i referohemi raportit të vitit 2010, në të cilin thuhet se Komuna e Prishtinës i ka 7 vendbanime joformale, dhe se janë munduar me i gjet ato vendbanime, por e kanë gjet raportin e 2005-tës, ku aty thuhet që janë 3 vendbanime joformale, përmendet lagjja Ramiz Sadiku, Dodona dhe Kodra e trimave. Sa i përket trashëgimisë kulturore e kemi listën e publikuar prej Ministrisë së Kulturës te vitit 2021.

Masar Dushi – pyet për zonën historike a hyn këtu apo është një linje e veçantë

Lyra Bakija-shton që hyn edhe zona historike me të gjitha asetet e trashëgimisë kulturore.

Mimoza Sylejmani- thotë se e ka kërkuar zyrtarisht prej Edonës një raport përfundimtar për kufijtë.

Edona Durguti – thotë se Ministria e Kulturës bashkë me Komunën e Prishtinës dhe UN Habitat-in kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi, ku janë duke e bërë planin e fleksibilitetit për kufijtë e rinj, po shpresojmë që ky plan do të përfundoj në dhjetor.

Perparim Rama- thotë që i bie pak vonë për këtë raport në krahasim me dinamiken në të cilën ndodhemi.

Mimoza SYLEJMANI- shton që siç e përmendi edhe Vllaznimi jemi në presion të madh nga publiku sepse ata nuk e dinë që ne i kemi këto probleme, që nuk kemi trashëguar dokumente të mirëfillta që na u kishin dashtë për këtë plan.

Luan Nushi- propozon që ju paralelisht mundeni me dal me një propozim për një kufi te caktuar deri të aprovohet dokumenti.

Edona DURGUTI- vazhdon duke thënë që ne mund të biem dakord për atë kufi të cilin e kemi propozuar, se kufiri i qendrës historike të Prishtinës nuk është kufi i vendosur qysh të gjithë siç duket e kanë prezantuar, asetet e trashëgimisë kulturore e kanë një perimetër dhe zonë mbrojtëse, nëse i vendosim zonat dhe perimetrat mbrojtës neve dalim te ai kufiri i cili veç është i propozuar ,është brenda ligjit për trashëgimi kulturore.

Nol Binakaj- shton se është proces që është stërgjate, ka pas iniciativa edhe më herët, p.sh prej Këshillit të Evropës pat qenë një studim i fleksibilitetit, besoj që është bazë e mire me u marrë, edhe të shikohen karakteristikat që sot kanë ndodhë edhe ndërrimet në teren, unë e kisha marrë edhe një hap tej, përpos të caktimit të kufijve, ish dashtë me pas nëngrupe me kritere të caktuara të zhvillimit, jo te trajtojmë njëtrajtësisht një zonë të tërë si zonë historike, nuk e di a po trajtohet edhe zona qendër, dihet që disa zona kanë një vlerë të caktuar në aspekt arkitektonik, ta bëjmë edhe një analize në këtë dimension.

Vllaznim Osmani – pyet se a mund ta sigurojnë një kopje te atij raporti te mëhershëm.

Ardita BYCI- shton se krejt problemi është se ne ndonjëherë kemi informata por meqenëse nuk janë të institucioneve publike nuk mundemi të i shfrytëzojmë, jo vetëm për trashëgiminë por gati për krejt fushat e tjera.

Arber Sadiki- thotë se duhet të gjejmë një konsensus se cilat janë parimet që duhet me i ndjek në rastet kur i hartojmë dokumentet e mëposhtme që është HZ dhe PZHK e mos me u ndal shumë në detaje, se siç duket është keqkuptuar se si punohet në këto dokumente, ne mund ta përcaktojmë se si i qasemi trajtimit të një zone po jo të përcaktojmë kufij ,se ne, nëse shkojmë deri në këtë detajizim atëherë çka na duhet HZ ose PRR të hollësishme, ne realisht po duam të kemi PRR të hollësishme vetëm për këto pjesë që janë specifike si rasti i zonës historike, ne nuk planifikojmë që me PZHK të lëshojmë plan me kushte ndërtimore ,këto gjera duhet të sqarohen në nivel të krejt Kosovës, duhet të sqarohen edhe me komunat e tjera, është një mundësi e mire që me e përcjell një model të mire se si mund të bëhen këto dokumente, se mendoj që e kemi për obligim edhe duhet, se jemi kryeqytet edhe duhet të jemi model që e ndjekin të tjerët. Edhe në takimin me UN-Habitat gjatë bisedës theksuam se nuk është vonë me e pas një dokument të mirë deri në fund vit që mundet me u përdor mandej për të definuar dokumentet tjera planore, por jo PZHK-në.

Ardita Byci- shton që ne nuk kemi nevojë më pas konsensus, sepse definimi i kufijve lidhet me HZ sepse në HZ p.sh kemi për ta caktuar një parcelë, për atë janë simbolet në normat teknike, se simboli e cakton në PZHK, parcela realisht nuk shihet në PZHK, këto janë probleme që keni me i pas edhe me Ministri.

Arber SADIKI- thotë se ne realisht nuk jemi fokusuar shumë se qysh do të reagoje Ministria, ne jemi marrë më shumë me atë se a ka sens krejt kjo çka po bëjmë ne, a është me të vërtetë ky ai Plan Zhvillimor Komunal qe duhet ta bëjmë. Ka qenë e mundur të krijohen me kohe disa praktika, për atë po them tani duhet të gjithë bashke ti caktojmë këto parime bazike, çka apo kujt po i themi PZHK edhe të kuptohet tek të tjerët që s'ka të bëjë me nivel të parcelës apo kufirit fiks se deri ku shkon. Më herët folëm edhe për zonat ekonomike, s'kemi me pas kufij por kemi me pas inercion kah është duke shkuar një korridor i cili është duke u zhvilluar, kaq. Unë pres që edhe në Ministri kur të shkojmë të flasim në këtë nivel.

Sadije Deliu– propozon që në këtë diskutim me e kyç prej fillimit edhe Ministrinë e Planifikimit edhe të Bujqësisë ose të jenë pjese e këtij grupi edhe ndonjë përfaqësues nga këto dy Ministri.

Luan Nushi- thotë se është pak problem në interpretim, se ligji nuk është fort gabim.

Sadije Deliu - vazhdon duke thënë se është çështja te ligji i bujqësisë qe është hartuar ne 2007-tën, në atë kohë s'ka ekzistuar HZ vetëm PZHK-ja, edhe ata iu kanë referuar PZHK-së sipas kufijve të përcaktuar.

Kryetari- thotë se atëherë kemi pas PZHK dhe Plan Zhvillimor Urban.

Sadije Deliu- e plotëson duke thënë se Ministria e Bujqësisë gabimisht i është referuar vetëm PZHK-së.

Luan Nushi- vazhdon duke thënë se problemi është te interpretimi, se kur është bërë ligji ne kemi kërkuar që në PZHK të përcaktohet edhe lokacioni edhe koeficientet, mandej i bie si paradoks se çfarë do mbetet në HZ mandej.

Kryetari – vazhdon duke shtuar se gabimi është bërë ne 2004-tën kur edhe janë përcaktuar densitetet.

Luan Nushi-vazhdon duke thënë se janë futur në proces të ndryshimit të ligjit, momentalisht thotë se janë duke punuar me ligjin në fuqi dhe se janë duke e diskutuar atë që e u tha më herët që PZHK-ja s'ka nevojë të jetë 700 faqe, por për Prishtinën p.sh kish më qenë mjaft 70 faqe, dhe thotë se deri tani kanë pranuar dokumente por Prishtina ka qenë kulmi dhe kur njëherë e kanë bërë një vërejtje dokumenti është kthyer me 100 faqe më pak.

Aida Dobruna- shton se ne si organizatë i kemi bërë 10 dite pune për ta analizuar vetëm profilin e dokumentit edhe për ta hartuar raportin e komenteve, edhe në fund nuk e kemi marrë dokumentin me pa a kanë reflektuar ato komente a jo dhe krejt ajo punë ka qene vullnetare.

Masar Dushi- i përshëndet krejt të pranishmit dhe propozon që ky plan i Prishtinës si kryeqytet të prezantohet dhe të lidhet edhe me 6 qendrat tjera rajonale qe i kemi, Mitrovice, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj e Gjilan

Kryetari-shton duke thënë se Prishtina si kryeqytet si zonë metropolitane veç lidhet me komunat përreth si Obiliqi, Fushe Kosova, Podujeva, Lipjani.

Lyra Bakija- vazhdon duke e diskutuar temën e banimit ku thotë se kanë probleme me të dhënat ku të dhënat e fundit i kanë nga ASK-ja dhe janë të vitit 2014-të duke marre parasysh zhvillimet e hovshme që kanë ndodhur viteve të fundit, thotë që janë duke u munduar që ta bëjnë një projeksion sa më të përafërt me gjendjen aktuale, mandej vazhdon që këtu kemi edhe shfrytëzimin e tokës, destinimin e sipërfaqeve, sipërfaqet e ndërtuara, sipërfaqet ujore dhe thotë se është edhe një shprehje këtu në draftin ekzistues si sipërfaqe të pashfrytëzuara.

Kryetari – vazhdon duke thënë se kjo pjesa ,si sipërfaqe të pashfrytëzuara në koncept janë disa zona që lihen si potencial për ndryshim, të pa destinuara me arsye dhe lihet si e tille, por këtu siç e kemi pa ne duhet të hiqet.

Ardita Byci- thotë që me udhëzimin administrativ të kategorizimi i tokës mundeni me ia gjet emrin.

Lyra BAKIJA- vazhdon me prezantimin duke kaluar tani te Planifikimi, korniza e zhvillimit hapësinor, dhe thotë që, vizioni që është përcaktuar është bërë sipas grupit punues dhe është Prishtina praktike, e pastër e gjelbër dhe e përjetimeve. Sipas këtij vizioni janë përcaktuar edhe qëllimet dhe objektivat strategjike, te zhvillimi ekonomik është llojllojshmëria e sektorëve ekonomik dhe objektiva për arritjen e këtij qëllimi është zhvillimi i zonave me potencial të ekosistemeve të reja, rrizhvillimi i zonave të caktuara me potencial ekonomik duke përfshirë tregun e vjetër, tregun e Ulpianës, tregun e gjelbër, të automjeteve e tjera, planifikimi i qëndrueshëm i korridoreve tregtare dhe hapësirave për tregti të mallrave dhe ushqimeve, zhvillimi i zonave të përshtatshme për energji alternative, zhvillimi dhe promovimi i zonave turistike duke përfshirë turizmin kulturor, shkencor, sportiv dhe atë rural, shumëllojshmëria dhe zhvillimi i bizneseve të vogla bujqësore duke u bazuar në burimet lokale, edhe integrimi i bujqësisë alternative me turizmin, ferma, agroturizëm, vreshtari e tjera. Qëllimi tjetër është me e kthyer Prishtinën në Smart city, objektivat për arritjen e këtij qëllimi është krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për zhvillim, zhvillimi i qëndrueshëm dhe i mençur i tregtisë, zhvillimi i energjisë dhe infrastrukturës energjetike me fokus te energjia smart , zhvillimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e turizmit smart edhe zhvillimi i ekonomisë qarkore. Te infrastruktura teknike qëllim është furnizimi i mjaftueshëm me ujë cilësor, ku është paraparë krijimi i shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë në krejt sipërfaqen e komunës, zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues, rritja e mbulimit të shërbimit të furnizimit, qëllimi tjetër është edhe menaxhimi i qëndrueshëm i infrastrukturës së ujërave të zeza ku objektivi është parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ujërat e zeza dhe zgjerimi dhe rivitalizimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe atij fekal. Qëllim tjetër është menaxhimi i qëndrueshëm i rrjetit të përmirësuar të ujitjes ku objektivi është zgjerimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e sistemit ekzistues të ujitjes. Qëllimi tjetër është furnizimi stabil dhe i pandërprerë i energjisë elektrike ku parashihet sigurimi i furnizimit me

energji elektrike pa ndërpre për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, rritja e kapaciteteve të furnizimit me energji të ripërtrishme edhe prodhimin e energjisë së ripërtrishme elektrike. Qellim tjetër është edhe shërbime cilësore të energjisë termike, ku parashihet shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve ekzistuese.

Nol Binakaj- propozon që prezantimin me pas komiteti në formën e shkruar, e këtu të diskutojnë vetëm pikat që ka hapësire për ndryshim.

Ardita Byci- propozon që të kalohet te tema e vizionit, mandej te skenarët, dhe thotë se vizioni është një moto, një deklaratë e cila deklaratë ka me u thur në bazë të potencialeve që i ka Prishtina, te cilat i shfrytëzojmë si premisa tona për t'u zhvilluar , mendimi im është që kjo me mbet si moto e Prishtinës.

Kryetari- thotë që kjo edhe është moto e zhvilluar dhe strukturuar si pjesë e dokumentit, tregohet çka është potenciali i Prishtinës si kryeqytet.

Aida Dobruna – propozon që vizioni duhet të bazohet edhe pak në plan hapësinor se Prishtina i ka disatribute që e percepton planin hapësinor se aty janë edhe potencialet, edhe nëse hartohet plani i ri nuk mund të ndërrohet shumë se aeroportin e kemi aty, Lipjanin, Obiliqin, Fushe Kosovën.

Sadije Deliu- shton duke thënë se Plani Hapësinor është plan që hartohet për një periudhë shumë të gjatë, mundet më pas ndryshime të vogla, por megjithatë nuk është si diçka që i skadon afati.

Nol Binakaj- thotë se ky vizioni i ri nëse mundet të ndikoj pak edhe planin hapësinor të Kosovës, sidomos për pjesën e Prishtinës s'ka asgjë të keqe.

Vllaznim Osmani- thotë se janë disa elemente që me të drejte po i përmend Aida që duhet me u përfshi se janë kriter, deklarata është pjesë e dokumentit, ne mundemi me e nda me ju, si koncept dhe ide nëse keni komete për të shtuar ne jemi të hapur ti dëgjojmë prej këshillit pa asnjë problem, po mendoj edhe po e them ndihuni të lirë me e thane atë se çka mendoni.

KRYETARI-vazhdon duke thënë se pikërisht të përzgjedhurit këtu jemi bërë bashkë për të dhënë një kritikë konsultive, për ta përmirësuar këtë dokument që është me rëndësi të madhe për zhvillimin e kryeqytetit në tetë vitet e ardhshme, për këtë arsye duhet me u marr me seriozitetin më të madh. Andaj këtu, përveç arkitekteve, urbanistëve, ekonomistëve, përfaqësuesve të trashëgimisë, matematicient, shoqëri civile, duhet shikuar dhe analizuar edhe prej perspektivave të ndryshme, për atë kemi pas takime me gati të gjitha strukturat relevante duke u munduar që prej secilit me i nxjerr nevojat dhe kërkesat që na duhen neve për këtë dokument. Patjetër që ky është dokument që është vazhdimësi e Planifikimit Hapësinor të Kosovës edhe pse ai është i vjetër por ndërlidhshmëria duhet të jetë, se kemi sot këtu fatkeqësisht edhe pse është deshtë me e pas deri tani edhe te riun ,andaj ndihuni të lirë dhe thuajeni krejt atë çka e sheh syri juaj kritik.

Ardita Byci- thotë se sa i përket vizionit po pajtohem shumë me Nolin, por edhe me Aiden, një vizion i një qyteti ka me u bazuar në vizionin apo karakteristikat që i ka jep plani hapësinor, por vizionet jo çdo herë ndërtohen duke u bazuar në një dokument, ne kemi edhe raportet për zhvillimin ekonomik që janë bërë për rajonet e Kosovës, edhe aty ka vizione, edhe aty është mire të bazohemi. Ajo thotë se vizioni mund të ndërtohet, i kemi disa burime edhe çdoherë duke e përdorur këtë origjinalitetin çka po duam të arrijmë.

Kryetari- thotë se përtej planit hapësinor të Kosovës, një pikë kyçe në aspektin e zhvillimit të mirëfilltë ambiental të ekonomisë okulare e tjera, tjera, dokumenti është në ndërlidhshmëri me planet zhvillimore të Green Agenda e Europe 2030, që është një baze e forte mbi të cilën ne kemi punuar, arsyeja është që ne të shkojmë paralel me vizionin Evropian, gjithashtu na mundëson joshjen e marrjeve të fondeve të mëdha prej IPA Found, e nëse ne nuk shkojmë paralel me to, 14.2 bilion që janë të dedikuara për Ballkanin Perëndimor mbasin të pa shfrytëzuara , kjo është edhe një pikë kyçe që jemi fokusuar ne.

Sadije Deliu- propozon që një vizion për me qenë vizion i mirëfillte përveç kritereve tjera duhet të dallohet pak, sepse ne kemi marrë pjesë në hartime të planeve në shumë komuna dhe në shume raste plani ka qenë kopje e një plani tjetër, dhe kjo shprehja “ e përjetimeve” që është përdorur këtu mua me pëlqeu shumë, është diçka që e dallon Prishtinën prej komunave tjera, por ndoshta mund të shtojmë edhe disa karakteristika tjera p.sh Universiteti, shkenca, inovacioni etj.

Ardita Byci- vazhdon duke thënë se planet e mëhershme që janë bërë kopje është pikërisht sepse e keqkuptojnë atë se çka thotë plani hapësinor, se duhet te përdoren të njëjtat strategji për zhvillim.

Sadije Deliu- thotë se edhe duan që të gjitha komunat të zhvillohen njëjtë si Prishtina.

Kryetari- vazhdon duke shtuar se sfidën kryesore e kanë pasur ndarjen e asaj çka kane pasur me atë se çka do të arrijmë në të ardhmen, në relacion me densitetin në bazë të statistikave 25% deri në 30% e asaj që është ndërtuar janë të zbrazëta, kemi banka që veç i kane ndaluar shërbimet për këto investime, dhe krejt kjo e tregon një trend të rrezikshëm. Ne normal që kemi presion në te njëjtën kohe prej zhvilluesve prej ndërtimtarëve, pronarëve të tokave dhe në te njëjtën kohë ne duhet te gjejmë një balancim duke mbrojtur interesin e përgjithshëm. Këtë duhet ta kemi parasysh edhe duhet me dal me një koncept, ne i kemi disa ide që duam ti qojmë përpara përmes rregulloreve, p.sh me ju thënë në rregull koeficientin e keni që po ta përcakton plani rregullativ sepse e keni blere tokën të bazuar në atë, mirëpo rregullat për zhvillim duhet të i përcaktojmë, edhe nëse nuk i përmbahen nuk mund të arrijnë atë koeficient.

Ardita Byci- propozon që të hiqet koeficienti krejt, dhe ndërtimi të bazohet në lartësi, shfrytëzueshmëri.

Sadije Deliu- thotë se si shoqatë e kanë komentuar shumë këtë problematikë të ndërtimit në mandatin e kaluar dhe as që e kanë marrë parasysh, 30% në kalkulimet e projeksionit janë 4 milion metra katrore banim në pyetje.

Ardita Byci – vazhdon dhe pyet Sadijen pasi ka qenë më e përfshirë përpara në këto projekte a ka qenë ndonjë demograf i përfshirë, që këto projekte mos të bëhen vetëm nga planerët dhe arkitektet, se ne, nuk mund të japim një numër për shtim natyror.

Vllaznim Osmani- thotë se për këtë çështje e kanë angazhuar Idrizin dhe Samiun.

Idriz Shala – thotë se ka rënie në shtimin e popullsisë, prej 1.7% ne 1.4%.

Aida Dobruna -shton se duke u bazuar me numrin e nxënësve për çdo vit 10% ka nxënës me pak.

Idrizi Shala–thotë se për 6 vjet sipas analizave prej 2013-2019 janë 50 mijë nxënës më pak.

Kryetari-vazhdon duke e ftuar të prezantoje propozimin e tij z. Qendrim Gashin.

Qendrim Gashi- propozon që në zhvillim e ardhshëm të Prishtinës të futen edhe elemente nga matematika,p.sh objekte në forma të ndryshme, ku në te njëjtën kohë edhe do të ishte edukative edhe do të mund të identifikohet Prishtina si kryeqytet, edhe pse ne e dimë që Prishtina identifikohet me Hyjneshtë në fron, pse jo edhe me ndonjë objekt gjeometrik që do të dukeshin bukur edhe do ishin më moderne p.sh në stacionet e autobusit, në rrugë, që do e bënin Prishtinën më unike.

Masar Dushi- vazhdon duke komentuar, se kapakët e puseve në rruge janë për faqe të zezë, edhe këtë ide po e huazojmë.

Sadije Deliu- vazhdon duke thënë që për me u ndërlidh me atë çka tha kryetari që ndoshta ky propozimi juaj kish për të shërbyer për pjesën vizuale të brandit të Prishtinës. Ne kemi përvojë në Vushtrri dhe Klinë ku përveç produkteve e kanë edhe brandin, që e ka sloganin e vet por e kanë edhe logon. Hyjneshtë në fron mundet më mbet si stemë zyrtare, ndërsa për me e brendu si qytet me e vendos në produkte, prej atyre promocionale e deri te kapakët e puseve mund të shfrytëzohet si ide.

Kryetari-thotë se këto janë tema që inkorporohen tek më vone, në aspektin e matematikës veç e kemi përmend ku themi Qyteti 7 minutësh, tani jemi në PZHK që është një matematike më e gjerë që e lidh zonën urbane me atë rurale, që e lidh Prishtinën me zonat tjera të Kosovës, jemi në fazën bazë të projektimit të vizionit për Prishtinën.

Arber Sadiku- thotë se mundet me u përfshi diçka prej asaj që u tha këtu, shumica prej neve këtu jemi marre me teorinë e formës dhe e dimë se për çka jemi duke folur, unë mendoj se mund të inkorporohet, edhe mund të kalojmë prej një Prishtine ku gjuhe estetike është dekori, në një Prishtine ku gjuhe estetike të jetë volumi dhe gjeometria. Se ne mund të kemi objekte të dekoruara bukur por nuk kemi pjesë të lexueshme të tërësive përmes formave gjeometrike, mendoj që është pjesë e vizionit, dhe mendoj që do të na ndihmonte në të ardhmen në përzgjedhjen e projekteve.

Nol Binakaj- thotë se mendon që edhe ju si administratë mund ta keni një vulë me logo p.sh.

Sadije Deliu- shton se mund të bëhet platforma e brendimit, që me e pas secilin element të planit urban edhe me i përcjell ato rregulla.

Ardita Buci- thotë se mirë që po i hapim këto tema se për mua janë të nevojshme se unë tezën e doktoratës e kam për “ Invisible patterns”, por duhet të bëhemi pak më konkret, unë krejt hallin e kam kur dokumentin e dorëzojmë në Ministri sa do të kuptohet kjo pjesë.

Sami Stagova- thotë se mendon që objektivat nuk dmth-në që si deklarate më qenë e matshme, se ne e bëjmë të matshme me konceptin që e tregon më vone dhe në fund me ndërtimin, edhe te vizioni nuk ka nevojë që krejt më qenë e përfshirë në vizion, por në atë se çka po duam të bëjmë, mendoj që ajo motoja “Prishtina praktike” është e mire, mendoj që çfarëdo lloj tjetër të kishim shkruar , praktike do të kuptohet, por mendoj që Prishtinën ta identifikojmë me diçka pak më lart, me pëlqeu puna e mjedisit dhe përjetimeve, por për praktiken ajo veç nënkuptohet. Vizioni nuk ka nevojë më qenë term i gjatë, por prej vizionit ndoshta mund të nxirret më shumë, nuk ka nevojë të detajizohen as qëllimet por me pjesët tjera i tregon se si do të arrihen ato qëllime.

Sadije Deliu- vazhdon se mund ta shtojmë edhe si Prishtina e qasshme apo e ecshme.

Luan Nushi- thotë se vizioni që është prezantuar këtu nuk e ka kuptimin e vizionit, është më shumë si moto. Vizioni duhet të qenë një ëndërr e zbatueshme, reale, e brenda vizionit duhet të përmenden ato qëllimet që i keni rendit, kjo 7 minutëshi mundet të qenë pjesë e vizionit.

Nol Binakaj- shton se te praktikat mundeni me tregu cilat kanë më qenë këto praktikat që keni me i ndërmarrë si administrate, edhe një prej tyre mundet të qenë 7 minutëshi.

Ardita Byci – thotë se 7 minutëshi nuk vlen për zonat rurale.

Sami Stagova- Natyrisht që duhet me e marr parasysh zonën rurale, por Prishtina e ka zhvillimin në zonën urbane.

Ardita Byci- thotë se ajo u shpreh në kontekstin sintaksor ajo është moto dhe deklarata e vizionit është diçka tjetër.

Kryetari- vazhdon se vizioni i kryeqytetit përkundër vizioneve të mëparshme e parasheh zhvillimin e kryeqytetit si tërësi, zona urbane me zonën rurale trajtohet si tërësi, se deri tani për shkak se nuk ka pas ndonjë vizion për zhvillimin e zonave rurale kemi probleme në aspektin e shërbimeve, p.sh ne me ligj duhet ti ofrojmë transport nxënësit që jeton në një vend që është më larg se 40 km prej shkollës. Për këtë arsye vizioni e parasheh zhvillimin e zonave rurale të rregulluara në aspektin ambientel të EURO 2030, ku përcaktohen fazat e zhvillimit nëpër fshatra të ndryshme, po ashtu edhe te branding që e diskutuam, që vjen në detaj gjithashtu, p.sh një etno fshat i artit e kulturës si Kukaj p.sh që mendojmë që duhet të definohet si një etno fshat ku edhe lejohet zhvillimi ,me qenë edhe si pjesë edukative, ose një fshat sportiv ose një fshat që është i fokusuar në shëndetësi që na e mundëson neve zhvillimin.

Ardita Byci-e pyet kryetarin se a i kanë paraparë të gjitha këto te fusha e zhvillimit ekonomik se po më duket që turizmi është një temë që duhet të trajtohet më detajisht, se s'keni vetëm turizëm kulturor, keni edhe natyror edhe turizmi rural, kur e përmendni si tërësi a janë këto te skenarët e zhvillimit.

Masar Dushi- thotë se te vizioni, te motoja “ Prishtina praktike” ky organizimi hapësinor sa është në harmoni me ligjin për Prishtinën sidomos te konteksti i organizimit të brendshëm administrativ, që fillon me bashkësitë lokale sot por nesër me komuna urbane, kjo është me rëndësi sepse rrjedhimisht veç e shkarkon shërbimin e administratës nga qendra, decentralizimi dhe shkon nëpër këto bashkësi lokale të vogla .E di që funksionojnë por jo në masën siç duhet, mos me e pas vetëm një adrese p.sh. të drejtorisë se urbanizmit, kjo realizohet me plotësimin e kriterëve të ligjit të brendshëm për Prishtinën, për atë edhe është ligji për Prishtinën që me i dhanë divizion më meritore Prishtinës si kryeqytet si tërësi urbane.

Ardita BYCI- propozon që në lidhje me skenarët të lihet një ditë tjetër për diskutim pasi që është pjesa më e ndjeshme, dhe prej aty mandej kemi për ta zhvilluar propozimin.

Arber Sadiku- thotë se ka qenë mangësi edhe në planet e mëhershme dhe po më duket që vazhdohet me të njëjtën mendësi që janë të barazuara planet zhvillimore komunale vetëm në sensin urbanistik, duke i mohuar krejt gjërat tjera më të rëndësishme si decentralizimi, ofrimi i shërbimeve e që ndërhyjnë direkt mandej te urbanizmi, është shumë me rëndësi ti kemi të definuara edhe këto.

Ardita BYCI- thotë se kjo hyn te skenarët e zhvillimit.

Aida DOBRUNA – pyet se në këtë aspekt a janë perceptuar nën qendrat e Prishtinës .

Sadije DELIU- thotë se në zonat rurale duhet me pas disa nën qendra që i shërbejnë fshatrave përreth.

Kryetari – thotë si pjese e procesit vetëm se kemi filluar me decentralizim përmes bashkësive lokale ose këshillave lokal për shërbime administrative që i ofron Komuna. Nëse ne e shohim përmes dendësisë që ka nevojë të shtohet edhe urbanizmi p.sh si shërbim nëpër këto qendra, mund ta bëjmë.

Ardita BYCI- propozon që skenarët të diskutohen me gjate në takimin tjetër, pasi aty kemi shumëçka për të diskutuar.

Nol Binakaj- thotë se kjo qasje mundet më pas ndikim edhe në ligjin për planifikim, pasi po rishikohet ligji, se thotë sa e di nuk ekziston ky planifikimi rajonal si kategori. Përderisa ka plot resurse që i ndan komunat ndërmjet veti po e zëmë, deponinë e mbeturinave, furnizimin me ujë, aeroportin e tjera, është e domosdoshme të decentralizohen rajone të caktuara.

Sadije Deliu- thotë se ligji në të kaluarën nuk i ka mundësi 2 komuna të hartohen bashkë.

Ardita BYCI- thotë se nëse e duam një Prishtinë metropolitane, nuk mundet të funksionojë pa këto zona funksionale, dhe thotë se skenarët e zhvillimit të Prishtinës nuk i sheh me këta kufij të prezantuar.

Luan NUSHI- shton se edhe duhet të jetë pjese e planit zhvillimor, si objektiv ose si qëllim, dhe thotë se nga përvoja e tij me lloj-lloj plane, nuk kemi qenë të kënaqur sepse përmbajtja është bërë vetëm formale dhe problemi qëndron se si të realizohen ato në teren. Është vetëm një grumbull i informatave të pa strukturuara, ku kemi tentuar në forma të ndryshme ta rregullojmë këtë situatë, kemi pas problem edhe brenda Ministrisë në interpretim të legjislacionit. E këtu kisha pas dëshirë që ta japim një ide, një shembull të zhvillimit të një dokumenti siç duhet, ne jemi gati të fundi se kur të caktohen objektivat dhe kur të caktohen skenarët për me i arrit këto objektiva këtu ish deshtë me u ndal plani zhvillimor, e ai skenari i përzgjedhur, ai është koncepti i ardhshëm i zhvillimit të komunës së Prishtinës. E mandej të vazhdohet me Hartën zonale për me i përzgjedh aktivitetet për zbatimin e objektivave.

Sadije Deliu- vazhdon duke thënë se për ato objektiva duhet të bëhet lista e prioriteteve.

Luan Nushi – thotë se me udhëzim administrativ kërkohet plan i veprimit në plan zhvillimor komunal, dhe mund ta bëjmë plan të veprimit por për objektiva prioritare.

Kryetari-thotë se dinamika mund të prezantohet në nivel të planit zhvillimor komunal, se ky plan është një vizion 8 vjeçar minimumi që i përcakton zhvillimet e nëse nuk i arrijmë këto, atëherë ky plan rishqyrtohet , e nëse i mbërrijmë ato objektiva brenda 8 viteve atëherë mundet me qenë vazhdimësi e 8 viteve tjera sepse po funksionon, e tjerat që p.sh nuk kanë funksionuar mund të ndërrohen. Gjithashtu në aspektin e ekonomisë në PZHK me i paraqit karakteristikat ekonomike të zhvillimit të kryeqytetit dhe ndërlidhshmërinë e të gjithë këtyre indikatorëve të ndryshëm statistikor që i kemi me ekonominë e qëndrueshme.

Alban Zogaj- thotë se deri tani këto dokumente kur janë punuar kanë qenë të përfshirë vetëm arkitekt dhe urbanist dhe janë lënë anash profesioniste të tjerë, dhe mendoj që duhet t'i lihet theks i veçantë zhvillimit ekonomik, zhvillimit shoqëror, aspekti hapësinor e merr krejt pjesën kryesore të dokumentit, e janë lënë anash sfera tjera të jetës, këtu edhe sporti duhet me qenë kyç, kultura, arti, këtu ish deshtë me qenë prezent edhe pjesëtar nga sporti, arti, unë personalisht jam duke u marr me pjesën e zhvillimit ekonomik, me objektivat dhe qëllimet që me i dhanë hapësire pak më të madhe.

Ardita Byci- thotë se planifikimi nuk nënkupton vetëm përfshirjen e urbanistëve dhe arkitektëve, planifikimi është shumëdimensional dhe në momentin që fillon një planifikim ne duhet me e pas

demografin, ekonomistin, sociologun, ekspert të trashëgimisë, bujqësisë, e tjera, realisht përfaqësues të krejt fushave.

Sadije Deliu- propozon që duhet të lexohen së paku të gjitha strategjitë sektoriale që komuna veç i ka aprovuar, edhe të reflektojmë se ky është dokument ombrellë i krejt këtyre.

Mimoza Sylejmani- thotë se i kemi kontaktuar dhe jemi takuar me krejt drejtoritë në mënyre që me i pas krejt informatat çka neve na duhen për planifikim.

Ardita Byci- thotë se puna më e madhe është mbledhja dhe harmonizimi i informatave.

Luan Nushi- rekomandon që të punohet në një dokument shume të rëndësishëm që ka mbet si draft e që është Harta Zonale e Kosovës, ku ka shume gjëra për Prishtinën.

Ardita Byci – thotë se ne këtu i kemi dy misione, misioni i parë është ta bëjmë një plan të mire dhe misioni i dytë është me i vetdijësu njerëzit që kanë për ta lexuar atë dokument.

Luan Nushi- thote se plani zhvillimor komunal p.sh për arsim nuk e cakton lokacionin por e cakton p.sh komuna e Prishtinës ka nevojë edhe për 20% me e rritë hapësirën shkollore, kaq, këtu përfundon plani zhvillimor.

Sadije Deliu- propozon që të përfshihet Ministria prej fillimit në këto takime.

Kryetari- propozon që neve na duhet një tabelë Excel sheet që e paraqet vizionin tonë për kryeqytetin, një Excel sheet me numra, duke marrë statistika duke filluar nga numri i banoreve, mandej në atë se çka po synojmë në aspektin e shëndetësisë, edukimit, sa nxënës duhet me i pas në një shkollë, sa e kemi dendësinë në zonat urbane, sa në ato rurale, çdo gjë është statistikë, numra , fjalë të paraqitura ne mënyrë skematike, e jo detaje, edhe krejt këto numra të lidhen me buxhetin që e kemi si komunë dhe çfarë shërbime mund të ofrojmë, cila është mundësia e ngritjes së buxhetit edhe zhvillimi dhe krijimi i një vlere shoqërore të mirëfillte, edhe këtu duhet të fokusohemi.

Sadije Deliu- propozon që argumentin më të mirë kur ta prezantojmë dokumentin është të fokusohemi te numrat, duke e pas parasysh që banimi e merr pjesën më të madhe në hapësirë , kur të bëhen projeksione për rritjen, mos me e marr 50 metra katrore për banore siç ka qene në draftin e kaluar, se ajo shifër as ne Evrope nuk është, në Ballkan 25 është i mjaftueshëm, ne nuk e kemi edhe atë standard.

Kryetari-thotë se nuk mendon që ne duhet të mendojmë ashtu që ne nuk e kemi standardin e jetesës sepse ne synojmë për ta krijuar një standard të mirëfillte për çdo qytetar, ne tani numrat i kemi 45 m katrore për koke banori për arsye se 30% i hapësirës është e zbrazët , dhe kjo është sfida jonë më e madhja, qysh me e ndalë këtë hov dhe si ta rrisim vlerën shoqërore në zonat e zhvilluara. Për atë edhe fokusi ynë është në rigjenerim e jo në zgjerim.

Vllaznim Osmani- thotë se këtë e kanë diskutuar edhe më herët se ajo ideja e planifikimit në metra katror duhet të ndryshohet dhe të fokusohemi te pjesa e vizionit tjetër ku potencohet kualiteti dhe vlera shoqërore, standardi i jetesës dhe interesi publik që e përcakton nivelin e zhvillimit.

Kryetari- vazhdon duke thënë se instrumentet të cilat jemi duke punuar në to janë rregullat në aplikimin për leje, dhe kërkesat që duhet te përmbushen si rezultat dhe niveli i kontributit për komunitet ku ne, do e fusim si pjesë të zhvillimit, po ashtu më qenë pjesë përbërëse e çdo zhvillimi. Prona dhe pronarët e tokave, zhvilluesi, janë dy që janë bërë bashke si pjesë e zhvillimit, ne tani jemi duke punuar në rregullore që me e fut edhe komunën, arsyeja është që më pas kontroll se në rast se bankroton zhvilluesi mos me mbet siç kanë mbet me dekada të pazhvilluara p.sh në qendër, por me pas qasje të drejtpërdrejt edhe në të njëjtën kohë me e marr atë përqindjen për komunitet, ne nuk kemi nevojë me nda toka për çerdhe, për shkolla, apo qendra për banim social, por duhet me i pas çerdhet e shkollat si pjesë e zhvillimit të këtyre zonave private ,të gjitha këto na minimizojnë ekspozimin edhe na rritë potencialin dhe kohën, duke i bërë tani për tani dhe pa i shfrytëzuar asetet e kryeqytetit. Deri tani ka qenë lirë për të ndërtuar, për atë edhe është ndërtuar në këtë mënyrë, se nuk janë përcaktuar rregullat e ndërtimit. Plus do të përfshihen edhe taksat, nëse një zhvillim nuk përfundon brenda dinamikës, taksa në atë zhvillimin ngritët. Në tërë këtë zhvillim që ka ndodh, ku janë benefitet e komunitetit, ky zhvillim veç ka shkaktuar probleme për komunitet, kemi kaos të trafikut, mungesë të rrugëve, kanalizimit, të ujit të pijshëm, të hapësirave të gjelbëruara, shkollave, d.m.th-në të gjitha zhvillimet kane shkuar kundër vlerave shoqërore, kjo duhet të ndërrohet, të gjitha zhvillimet duhet më qene për komunitetin së pari.

Aida Dobruna- thotë se te zhvillimet ka qenë mungesë e kodit të ndërtimit dhe normave tjera që caktohen. Duhet të përcaktohen kushtet për ndërtim, komuna duhet me i udhëheq edhe aty gjërat, nuk duhet të lejohet ndërtuesi të bëjë çfarë të dojë.

Masar Dushi- e pyet kryetarin për dinamikën e realizimit të PZHK-së.

Kryetari- thotë se po mundohen ta përfundojnë më herët, edhe pse është caktuar deri më 30 shtator, janë duke punuar me intensitetin më të madh, normal që duhet një bashkëpunim dinamik i ndërsjellë edhe mendon se nëse i intensifikojnë bashkëpunimet dhe takimet mundet të kryhet më shpejtë.

Vllaznim Osmani- vazhdon duke i pyetur pjesëtarët e komitetit se a është më e rrugës të ndahen në grupe e të punojnë, apo të kryhet e mandej të ju lihet hapësirë juve për komente, ai vazhdon se për ne si komunë cilido proces është në rregull, dhe thotë se ne kur e kemi krijuar këtë grup e shohin kontributin e juaj si shumë të rëndësishëm në këtë dokument.

Ardita Byci- propozon të mos punohet në mënyre individuale por të krijohet si punëtori e mandej brenda asaj punëtorie mund të ndahen në grupe, edhe mundësisht takimi i radhës të bëhet sa më shpejt që mos të lihet hapësire dhe shumë në kohë.

Aida Dobruna- propozon që si përfaqësues të shoqërisë civile dhe si organizatë që vet financohen të paguhet për kontributin e tyre, mendon që është e drejtë dhe meritore pagesa.

Kryetari- i falenderon për pjesëmarrjen dhe thotë që gjithsesi e gjejmë një modalitet dhe e diskutojmë me zyrën ligjore dhe drejtoreshën e financave çështjen e pagesës.





HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Komiteti Konsultativ

RAPORT 2

DATA: 12/10/2022

VENDI: KOMUNA E VJETËR

TAKIMI ME Komitetin Kosnultativ

PJESËMARRES NË TAKIM:

1. Perparim Rama
2. Alban Zogaj
3. Vllaznim Osmani
4. Mimoza Sylejmani
5. Arber Sadiki
6. Aferdita Gashi Sinanaj
7. Lyra Bakija
8. Luan Nushi
9. Masar Dushi
10. Ardita Byci Jakupi
11. Nol Binakaj
12. Lumnije Gashi
13. Sadije Deliu
14. Edona Durguti
15. Sami Duraku
16. Idriz Shala
17. Sami Stagova
18. Besnike Kocani

PROCES VERBALI

Arber Sadiku- i falenderon të pranishmit për pjesëmarrje në takim, dhe e fillon duke thënë se siç u diskutua në takimin e kaluar, dhe në baze të asaj se çfarë është propozuar nga grupi, ne dokument veç

është punuar më detajisht, që së shpejti do të prezantohet këtu, gjithashtu kemi thënë që bashkë të merremi edhe me skenarët, që është pjesa më thelbësore e krejt dokumentit, i kemi shtypur edhe hartat e mëhershme. Mbi bazën e vizioneve që i kemi diskutuar në takimin e mëhershëm ne kemi filluar me i vendos këto vizione nëpër harta dhe e pamë të rrugës me i shtyp që t'i diskutojmë së bashku. Ndoshta Lyra me Afërditen munden tani më gjerësisht të na flasin rreth punës që është bërë deri tani.

Lyra Bakija-vazhdon me prezantimin që shihet edhe në projektor, dmth-në Prishtina praktike, qendër metropolitane me zhvillim dinamik e të qëndrueshëm social ekonomik e mjedisor. Një kryeqytet i fokusuar në cilësinë e jetës së qytetarëve, një kryeqytet 7 minutësh që përmes mobilitetit të qëndrueshëm ofron nxitje të ekonomisë lokale, mirëqenie, cilësi më të mirë të ajrit si dhe forcon ndjesinë e komunitetit. Një Prishtine reziliente me aftësi absorbimi, rikuperimi dhe përgatitje në rast të fatkeqësive natyrore, ekonomike dhe atyre sociale. Kryeqytet gjithëpërfshirës i cili fuqizon dhe zhvillon potencialet e llojllojshme të fshatrave, destinacioni i pashmangshëm i ballkanit perëndimor për përjetimin e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe shpalosjen e historisë. Një kryeqytet smart i cili përmes teknologjisë dhe inovacioneve përmirëson shërbimet e ofruara për qytetaret. Këto janë pikat se çka e bëjnë një Prishtine praktike, te Prishtina e pastër dhe e gjelbër kemi thënë një kryeqytet me ambient të pastër dhe kualitet të mirë të resurseve natyrore, duke përfshirë ajrin, ujin dhe tokën, atraktiv për qytetarët dhe vizitorët, në aspektin e pastërtisë sidomos përmes menaxhimit efikas të mbeturinave, kryeqytet eco-friendly i bazuar në lëvizjen e lirë të qytetarëve kryesisht përmes mjetit modern të transportit publik edhe shtigjeve të gjelbëra. Te Prishtina e përjetimeve kemi thënë Prishtina do të jetë reference ndërkombëtare për promovimin e kulturës, së paqës e qytetërimit, dashurisë, të zhvillimit social me një jetë cilësore që promovon kohezionin social dhe solidaritetin në zhvillim, vatrë e mbështetjes dhe inkurajimit të zhvillimit të talenteve të shumta të rinisë së vendit, në sport, art, kulturë dhe në çdo fushë tjetër. Këto janë pikat kryesore të cilat kemi vendos me i shtjellu dhe me i detajizuar në skenarët që i kemi parapare. Nëse keni diçka për të shtuar.

Masar Dushi- thotë se duke u bazuar në vërejtjet dhe komentet e takimit paraprak, kush është përcaktues i këtyre pikave që janë marrë si prioritet.

Lyra Bakija- thotë se përcaktues i këtyre pikave që janë marrë si prioritet është grupi punues, janë drejtorët, është kryetari janë nënkryetaret që kanë vendos, por kjo nuk do të thotë që këto janë përfundimtare, për atë është edhe ky takimi që nëse ka nevojë të shtohet apo hiqet diçka, çka të shihni ju më të arsyeshme.

Luan Nushi- thotë se kjo e sotit ka dallim të madh prej herës së kaluar, në cilësi është ngrit shumë.

Lyra Bakija – thotë se ka qenë vetëm Prishtina praktike e gjelbër dhe e përjetimeve, ka qene si lloj moto, tani i kemi përshkruar pak a shume secilën, karakteristikat e secilës, por nuk do të thotë që është vetëm kjo, kjo është vetëm deklarata e vizionit, më tutje do të zhvillohet secila pikë, ka me u cek zhvillimi dinamik i qëndrueshëm, kryeqyteti 7 minutësh te pjesa e mobilitetit etj.

Sami Stagova- thote se sot ka pritë që do të diskutohet për vizionin sepse konsideron që disa vërejtje që janë bërë sidomos për popullsinë, demografia është problemi kryesor që ka mundësi të ndikojë edhe në vizion.

Lyra Bakija-vazhdon duke thënë që drafti që ju e keni është i profilit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese, prej atij momenti drafti është punuar dhe plotësuar, te pjesa e demografisë, tash e kemi një

projeksion të popullsisë pak më reale që e përfshinë komunën tonë, kemi edhe elemente tjera që kemi pas mungesë të dhënash e që jemi munduar maksimalisht me i plotësua, por gjithsesi vërejtjet e juaja duhet me i marr për bazë, mire kishte më qenë që me i pa vërejtjet që mandej edhe ne me pa ku e kemi punuar e plotësuar draftin.

Idriz SHALA- thotë se tani me shënimet e reja që i kanë marrë, pjesa e demografisë ndryshon prej draftit që ju e keni ,tani është e ndryshuar.

Lumnije Gashi-thotë se dokumentin që e ka marrë, e ka konsideruar që është një draft që është ripërpunuar dhe me shume vëmendje e ka krahasuar me versionin e fundit që në atë kohë është dërguar në Ministri. Organizata jonë i ka pas 23 faqe komente, shumica prej tyre me përmbajtje shumë serioze lidhur me disa tema që kanë qenë problematike në dokument. Ajo çfarë kam parë në këtë dokumentin e ripërpunuar është që përpos hartave që janë shkoqit, e që mendoj që është gabim, se mungesa e tyre na pamundëson të kuptuarit dhe ndërlidhjen e pjesës tekstuale me hapësirën. Një pjesë e tekstit mendoj që është bërë mire që është hequr se ka qenë shumë voluminoz, por në përmbajtje të dokumentit nuk është punuar shumë, prandaj ato 23 faqe komente tonat besoj që shumica prej tyre qëndrojnë. Gjithashtu ka pjesë që janë të mangëta, vetëm është hequr komplet teksti dhe ka mbet titulli i fushës tematike. Neve me vendim na është dhënë detyra me dhanë mendime dhe komente profesionale me shkrim në një punë të cilën e bën ekipi punues, nuk jemi të mandatuar ta hartojmë dokumentin. Pritshmëria ime në takimin e sotit ka qenë që neve të na ofrohet një draft që ju e konsideroni që është i gatshëm e që ne kemi mundësi me e dhanë kontributin tone. Unë kështu e shoh.

Ardita Byci Jakupi- thotë se edhe ajo ka komentuar në draftin që e ka pranuar, së pari thatë që është një profil dhe analizë e gjendjes ekzistuese, unë mendoj që ishte një profil i gjendjes ekzistuese nuk pat analizë, shumica e komenteve të mia lidhen me atë se çfarë vlerësimi keni dhënë për fushën e caktuar tematike, dmth-në ajo mungon. Ka komente shumë por po i diskutojmë ato çka janë më me rëndësi, p.sh. për tregtinë shkruhet në mënyre shumë të përgjithshme duke e pas parasysh që ne kemi shumë rëndësi si kryeqendër, pastaj për industrinë, për turizmin flitet shumë në mënyre të përgjithësuar, ndoshta është si rezultat i asaj që jeni munduar të hiqni sa më shume tekst mirëpo ai tekst është dashtë të përpunohet sidomos kur flitet për një fushë të caktuar tematike gjithsesi duhet më qenë një konkluzion në fund, dmth-në, ju e prezantoni gjendjen ekzistuese por duhet me e dhanë një vlerësim mbi atë gjendje. Kam mjaft komente por nuk e di në sa përqindje dallon ky draft nga ai i kaluari. Një prej komenteve ka qenë që ka munguar pjesa grafike që ka qenë e pamundur shumë të dhëna me i përcjell, sidomos kur flasim për menaxhim të mbeturinave që është një detaj bukur i rëndësishëm për kryeqytetin mandej një prej komenteve është që shumë duket që i referoheni zonës urbane dhe e neglizhoni zonën rurale.

Lyra Bakija- shton duke thënë që hartat mungojnë për shkak që ka qenë shumë problem me të dhënat ekzistuese të cilat i kemi në sistemin e Gis-it, jemi duke punuar vazhdimisht për me i vendos ato harta.

Lumnije Gashi -pyet se kompania a nuk i ka dorëzuar hartat si file, se janë këto probleme që neve duhet t'i diskutojmë.

Lyra Bakija-thotë se ata kane dorëzuar diçka por në formën që i kane dorëzuar kanë qenë të papërpunueshme, edhe është dashtë të bëhen krejt prej fillimit, sidomos të shfrytëzimi i tokës edhe krejt elementet tjera, prandaj juve në tekst kur e keni marrë draftin ju ka ardhë me "final" e unë i kam ku mbas çdo kapitulli apo nënkaptulli, është aty të vendoset harta, se aty ende kemi mbet, se ende

është draft punues. Sa i përket hartave ky ka qenë problemi nuk është që ne kemi vendosur të mos ketë harta në pjesën e profilit dhe vlerësimit të gjendjes se e dimë sa është elementare ajo që më qenë pjesa grafike në tekst por ende nuk e kemi të përpunuar si duhet që me qenë pjesë e tekstit. Kurse te pjesa tjetër që e përmendet që është pjesa e zhvillimit ekonomik, me neve këtu është edhe nënkryetari si ekspert i asaj pjese, që është duke u marrë me atë pjese, ajo pjesë ka munguar në draftin e juaj por shumë shpejt ka me qenë pjesë e draftit.

Lumnije Gashi- thotë se sfidat nuk janë të identifikuara, duke pas parasysh që po flitet për një draft që 90% është i ngjashëm me draftin e kaluar.

Sadije Deliu- propozon që çka kish me e ba ndryshimin është që shpjegimi me pas indikator, me pas numra, në të cilat mandej mund te bazohen edhe sfidat, edhe sfidat me qenë me numra, edhe mandej ndoshta mund te kalojmë te objektivat, me u marr prej sfidave me u përkthi dhe me qenë mandej të matshme. Se e kam vërejt që disa prej tyre nuk janë të matshme.

Aferdita Gashi Sinanaj- vazhdon duke thënë se drafti i kaluar në pjesën hartografike ka kaluar pa asnjë milimetër katror industri. Gjithë ky kryeqytet nuk e ka pas as edhe një objekt që prodhon sipas draftit te kaluar.

Lumnije Gashi- vazhdon duke e plotësuar se e ka pasur zonën industriale.

Aferdita Gashi Sinanaj-thotë se nuk e ka pas as edhe një fabrike, thotë se ne e kemi marrë e kemi përpunuar prej fillimit gjendjen ekzistuese, sot e kemi një draft të gjendjes ekzistuese të cilën mundemi me e shpërnda pa pike problemi, normal që gjithmonë ka vend për përmirësim, por është ekzistuesi dhe është shumë më real, shumë më i përpunuar se drafti që ka qenë.

Ardita Byci Jakupi- kërkon që të i dorëzohet grupit konsultativ drafti i fundit.

Lumnije Gashi- vazhdon duke thënë se nëse e konsideroni që gjendjen ekzistuese e keni përfunduar, ju lutem na e dërgoni, dhe thuajeni që faza e parë është përfunduar, dhe i presim komentet prej juve, edhe ne i lexojmë dhe i përpunojmë komentet.

Aferdita Gashi Sinani- thotë se deri në fund të javës i përpunojnë të gjitha hartat me PDF edhe do i dergojnë.

Masar Dushi- thotë se i bashkëngjitet vërejtjeve të mëherëshme dhe mendon që ka ende punë për tu bërë në këtë dokument, ka shumë gabime formale dhe joformale në emërtimin e pikave, p.sh. mendoj që i mungon ai dimension i porti i thatë(port në kuptimin e zhvillimit ekonomik) e që është edhe turizmi i ndërsjellë. Tjetra, te emërtimet, nuk ka trashëgimi jugosllave, por ka trashëgimi në kohën e ish Jugosllavisë, nuk ka qytet otoman, por ka qytet me stile otomane ose arkitekture otomane, edhe te zona historike duhet me e marrë një forme, te objektet fetare ishe ajo “ kisha ortodokse serbe” në qendër, une jam shume kundër që të quhet ashtu, mendoj qe duhet te thuhet ndryshe, qe mos me i dhanë legjitimitet.

Perparim Rama- thotë që objekti faktikisht me pas kahjen ka pengesa e jo kahjen e funksionit, me e quajt p.sh objekti ilegal në Kampusin Universitar.

Masar Dushi- vazhdon duke thënë se edhe demografia lë shume për te dëshiruar, dikund i kemi 180 mijë banore, dikund 290 mijë me një plotësim, a unë jam shume i bindur qe i kemi mbi 400 mijë banore. Unë

mendoj që Prishtina si kryeqytet duhet të absorbojë min 25% të popullatës të Kosovës, nuk është rastësisht kryeqytet, e sidomos të demografia është shumë e ndjeshme, aq më tepër kur ne jemi në një tranzicion demografik ,duke iu referuar edhe asaj se çka vjen tutje.

Idriz Shala- thotë se kanë marrë çdo të dhënë të mundshme që qytetarët në komune i kryejnë si shërbime që mundet me na drejtu përafërsisht, kemi bërë vizita në të gjitha institucionet. Drafti që ju e keni, e që foli më herët Aferdita nuk është drafti final i përpunuar. Kemi të dhëna zyrtare me statistika që i japin vullën e fundit këtij dokumenti. Ne kemi pasur takime të ngushta me entitetin e statistikave, duke i analizuar edhe faktorët e tjerë, ujësjellësin, energjinë elektrike, mbeturinat, tatimin në pronë etj. Prishtina e ka rolin e vet, në mobilitetin e lëvizjes, drejtoria e rrugëve na ka njoftuar që deri në 125 mijë vetura hyjnë gjatë ditës , por është interesante që mbi 60% e tyre 1 person vjen me 1 veturë këtu. Të gjitha këto i kemi analizuar dhe për atë ndoshta edhe jemi me vonësë pak në draftin final.

Masar Dushi- propozon që grupi të takohet më shpesh, thotë se ne i kemi 4 linja për t'i diskutuar, 1) Profilin komunal, 2) Vlerësimi i gjendjes, 3)Korniza e zhvillimit, 4)Zbatimi dhe monitorimi. Takohemi p.sh vetëm për të diskutuar profilin komunal edhe e mbyllim këtë çështje, mandej me radhë. Korniza e zhvillimit na merr më shumë kohë, t'i analizojmë veçmas në tekst, ta krijojmë edhe ta mbyllim.

Lumnije Gashi-thotë se e ka një vërejtje të vlerësimit i gjendjes, ky është një gabim që është bërë në udhëzimin administrativ, nuk duhet të ndahet vlerësimi i gjendjes ekzistuese prej profilit. Sugjerimi është që të bëhen bashkë, e ke një profil, e vlerëson gjendjen, i identifikon sfidat, kërkesat, nevojat zhvillimore mandej më lehtë kalohet te objektivat dhe qëllimet e objektivave. Nëse e konsideroni që pjesën e profilit dhe vlerësimit të gjendjes e keni të gatshme, dërgonani, ne e kemi për detyrë ta lexojmë dhe ti bëjmë komentet me shkrim, dhe kështu shkojmë fazë pas faze. A kështu qysh është menduar sot, dokumenti ka mangësi, është pakëz e mundimshme për të vazhduar.

Sami Stagova- thotë se ne ende nuk e kemi të qartë se cili është dokumenti, një dokument që e kemi pas, e kemi shqyrtuar, kemi shumë vërejtje. Ju po thoni që e kemi draftin final, dërgonani me e pa edhe në takimin e radhës ne vijmë me komente të reja.

Ardita Byci Jakupi-propozon që kish më qenë mire me i marrë parasysh edhe këto vërejtje që i kemi dhënë sot, sidomos në aspektin e vlerësimit, sepse nuk mundesh me e lexu një gjendje ekzistuese për një fushë tematike pa e pas një vlerësim.

Lumnije Gashi- thotë se me Giz-in gjerman e kanë pas një projekt ku e kanë zhvilluar një doracak për vlerësimin e planit zhvillimor komunal dhe hartës zonale. Ideja ka qenë që me ia ofruar ministrit një dokument për ti vlerësuar planet në mënyrë shumë ma objektive sepse kemi pa që ka shumë dallime mes vlerësime të komunave, dhe pikërisht për mungesë të kriterëve për vlerësimin e planeve. Si parim ideja ka qenë me e ba një dokument të përdorshëm për ministrinë, por edhe për komunat , si një vetëvlerësim i planeve. Ky dokument e ka njësinë tekstuale, janë treguesit kryesorë që nuk bën një plan komunal zhvillimor mos me i pas, e që profili të zhvillohet në baze të disa treguesve, sepse ata tregues mandej përkthehen te objektivat. Instrumenti tjetër që përdoret është pjesa Excel si check- listë, e ke p.sh demografia-a i ka këto tregues , ekonomia-a i ka këto tregues, është i kalkuluar që automatikisht e bën vlerësimin edhe e sheh sa përqind në baze të treguesve dhe kriterëve e ke kualitetin e dokumentit. Unë mundem me ju ofru doracakun që të paktën të kaloni nëpër të edhe e shihni se ku qëndron dokumenti.

Sadije Deliu- propozon që së paku mundeni me e përdor si tabele të përmbajtjes, e kur i qitni nëntitujt p.sh a i keni krejt nëntitujt, çka ju nevojitet, çka mungon që me shtu e plotësu.

Sami Stagova-thotë se realisht mandati jone është më dhanë komente, p.sh u fol për demografinë që veç i keni bërë analizat, unë kisha thënë që këto të merren si të mirëqena se nuk kemi më çka me shtu, janë njerëzit kompetent që i kanë dhënë ato të dhëna, ne më shumë mund të fokusohemi se qysh janë përdorur ato të dhëna edhe qysh janë bërë analizat për të vazhduar tutje. Unë mendoj që më shumë isha fokusuar në atë pjesën përmbajtësore se çka jemi duke dashtë me ba me Prishtinën, që mos me shku në detaje por në gjërat kryesore . Unë me shume isha koncentruar te zhvillimi, te propozimet. Mua më vjen mire që herën e fundit qe e kemi diskutuar vizionin, ju e keni përpunuar.

Ardita Byci Jakupi-thotë se ka pak mëdyshje, p.sh nëse e marrim zonën industriale, te zona industriale është industria e përshkruar si cilat janë industri, edhe më shumë i është dhënë prioritet a është shpk. apo biznes privat, a neve na duhet me e dite çfarë kategorie e industrisë është, a është industri e lehtë, çka prodhon, e krejt këto ndërlidhen me skenarët, ose te turizmi që është komponenti themelor e që është vetëm e shkruar si turizëm , as nuk i kemi produktet turistike, as nuk e dimë çfarë lloj turizmi është, me duket qe nuk kemi brumë shumë, është i mangët.

Sadije Deliu- thotë që zakonisht kjo punëtori e skenarëve duhet të zgjas tërë ditën, edhe duhet me e pas një liste të qartë të objektivave dhe qëllimeve dhe mandej ato kontekstualizohen në hapësire.

Nol Binakaj – pyet se ne baze të gjetjeve të reja që jeni duke e përpunuar profilin e gjendjes ekzistuese me analiza, a ka ndryshuar ai skenari qe e keni aprovuar qysh në fillim, sa kanë pas ndikim këto të dhënat e reja në zhvillimin e skenarit.

Luan Nushi- thotë se sipas skenarit në versionin që e kemi, është paraparë 4.9% rritja e popullsisë, që është shumë, është maksimal dhe unë mendoj që është i bazuar në një analize 60 vjeçare të rritjes së Prishtinës e që nuk i përshtatet trendit tani, ose skenari racional që është 2.9% e që prap është shumë, sot diku rreth 1.1% ose 1.2% është shtimi i popullsisë që po i bie që jemi duke folur për një analizë jo fort korrekte. Është mirë që këtë dokumentin e ndryshuar, ta marrim , ta analizojmë dhe herën tjetër te flasim me konkretisht.

Sadije Deliu- thotë se unë kisha propozuar që të mos japim vetëm vërejtje por edhe propozime, se ne e dimë qe është punë e ngarkuar plus edhe me kapacitete vetanake, mendoj qe është e rrugës që të shkojmë me propozime më shume.

Lumnije Gashi-propozon që në këto takime të marrin pjesë edhe zyrtarë të drejtorive, se është shumë e rëndësishme sepse ky dokument do të zbatohet prej tyre, ky duhet te jete një proces i brendshëm i ngritjes se kapaciteteve, këshilla ime kish më qenë që të angazhohen sa më shumë sepse ata kanë më qenë zbatues të këtij dokumenti.

Mimoza Sylejmani- thotë se në fillim ka qenë grupi punues që i ka mbledh të dhënat krejt në nivel të zyrtarëve publik çka janë, në vendimin e ri kryetari e ka marr vendim që të punohet në nivel drejtorësh. Ju e keni pa dokumentin mbi 600 faqe, edhe kryetari ka tentuar diçka tjetër siç është kjo që jemi mbledhur sot, jo prej dëshirës të madhe.

Lumnije Gashi-thotë se unë e di si ka qenë por ata janë zyrtarë dhe atyre ka me ju ra barra, nëse jo të planifikimit të urbanizmit gjithqysh.

Aferdita Gashi Sinanaj- thotë se për ta plotësuar atë çka tha Mimoza, ata zyrtaret i kemi trajnuar për ta përdorur sistemin e GIS, sot nuk janë këtu por ne për çdo gjë jemi në konsultim me ta se ju e dini që ata janë kaherë këtu, janë si data bazë.

Mimoza Sylejmani- vazhdon duke thënë se përndryshe për herë të parë e kemi marrë licencën për platformën GIS që veç ka filluar të instalohet nëpër zyre, deri tani i kemi aftësuar 10 punëtorë të drejtorive të ndryshme, nuk është që ne i kemi anashkaluar ata, se ne me ata kemi për të punuar, ndoshta jo në vendimmarrje por si pjesë e procesit janë.

Ardita Byci Jakupi-thotë se ka shumë punë për t'u bere, e në lidhje me skenarët, unë nuk kam mbërri te pjesa e skenarëve ende, por më bëri përshtypje Luani që e tha ma racional dhe maksimal.

Lyra Bakija- vazhdon duke thënë që Luani ishte duke folur për projeksionin e demografisë në draftin ekzistues, tani është bërë analize tjetër prej Idrizit edhe tani nuk ekzistojnë ato skenarët maksimal, minimal dhe racional , ekzistojnë si tabela por nuk përmendet asnjë metodologji. Me analiza tani , me gjithçka, ka dal që numri i banoreve ne nivel të komunës është 290 mijë.

Ardita Byci Jakupi- pyet se kur mund ta marrim draftin e ri .

Lyra Bakija- thotë se deri ne fund te javës drafti do te jete gati.

Perparim Rama- propozon që ndoshta është më mire mos të ngutemi, kisha më thanë që më mirë të bëjmë edhe një shqyrtim të pikave që janë paraqitë sot këtu, edhe në bazë të tyre mandej me dhënë një përgjigje kur bëhet gati. Nuk e di a janë bashkangjitë në dokument edhe aspektet e ekonomisë. Dmth-në ka ende pika shtesë që punohet paralelisht që nuk janë pjesë e dokumentit e që duhet me qenë. Unë propozoj që mos te ngutemi , kur t'i shikojmë të gjitha e t'i analizojmë me grupin e dorëzojmë draftin e ri dhe do të takohemi më shpesh, do të kemi punëtori tërë ditore.

Lumnije Gashi – thotë se punëtorja mos po bie ndesh me mandatin tonë që e kemi në këtë grup.

Masar Dushi- thotë se me punëtori nuk do të thotë që ne të hartojmë, por mund të analizojmë , këshillojmë, nuk i marrim ne kompetencat e as përgjegjësitë e hartuesit, ulemi debatojmë, vijmë në një përfundim edhe mbyllet, unë mendoj se punëtorja është më se e nevojshme.

Mimoza Sylejmani- vazhdon duke thënë se e ka një pyetje për grupin e që i është bere në takimin e sotit me banorët e Kalabrisë, a kemi të drejte ne kur të votohet si plan zhvillimor kjo, te vazhdojmë direkt në plan rregullues të hollësishëm pa u bërë harta zonale.

Luan Nushi- vazhdon duke thënë se shpjegimi është pak problematik i ministrisë, thotë se edhe me plan zhvillimor komunal edhe me hartë zonale mund të caktosh zonat për të hartuar planet rregulluese.

Lumnije Gashi – thotë se mos gaboni në Pzhk të definoni kufij ndërtimor, zhvilloni projeksione por asesi kufij se mandej ka për të ju shkaktuar telashe kur të arrini te Harta zonale.

Perparim Rama- vazhdon duke thënë që si e kuptova unë, mund të bëjmë plane rregulluese edhe me Pzhk edhe HZ, dhe në momentin që votohet Pzhk-ja mund të fokusohemi në Kalabri dhe paralelisht edhe

Hartë Zonale, ndoshta është edhe një instrument tjetër që e shpall zonë të interesit Kalabrinë me PZHK dhe e shqyrtojmë mandej në aspektin e planit zhvillimor të hollësishëm.

Sadije Deliu- thotë se ajo është më e sigurt, nëse e përcaktojmë si zonë të interesit me Pzhk.

Ardita Byci Jakupi – thotë se në momentin që ju doni me përcaktu kufijtë e planeve rregulluese të hollësishme të cilët kufij kanë me u përcaktu me Hartë zonale, tani mendoj që kanë me kërkë gjithsecili plan rregullues.

Arber Sadiki- thotë se për të mos i banalizuar tash gjerat, ne e dimë të gjithë edhe ata në Ministri se Pzhk-ja e tregon kah ka me shku zhvillimi i një komune nuk përcakton kufij, ne në asnjë mënyre nuk pranojmë të dërgojmë harta me Pzhk ku trajtohen kufij, në nivel parcellë etj, se atëherë s'ka sens bërja e Hartës zonale, edhe mendoj që ne duhet me i shty përpara proceset tona edhe nuk duhet më qenë peng, edhe me e kriju një model se si duhet të bëhen tash e tutje krejt Pzhk-të dhe Hartat zonale, se Prishtina duhet më qenë model.

Perparim Rama- thotë se unë si e shoh edhe është e ligjërishme me e përdor, por ne kemi disa procese burokratike që po na mendojnë dhe ngadalësojnë zhvillimet e disa pikave me rëndësi të madhe për kryeqytetin, rruga A në këtë aspekt por edhe padrejtësitë apo ngutjet që janë bërë më herët. Vitin e kaluar p.sh prej 1.8 e kanë ngit në 2.4 koeficientin në Kalabri edhe ne, për shkak të Ministrisë është dashtë me e shfuqizu.

Ardita Byci Jakupi-vazhdon duke thënë se ka qenë prezentë dhe vet e ka bere revidimin e projektit për kompaninë, paralelisht kur ka dal tenderi për revidim ka qenë Arbëria 3 dhe Kalabria, Arbëria është aprovuar dhe Kalabria nuk është aprovuar për shume çështje që është kuptuar mes rreshtave. Për Kalabrinë mënyren qysh ka dal Komuna, zyrtarët komunal me një ngritje të koeficientit, as pa e thirrë kompaninë hartuese, jemi habitur, ka dal në asamble dhe është votuar, ky rezultat i ngritjes nuk është rezultat i planit të reviduar. Ndoshta kish më qenë më mirë të analizohet pak ky koeficient, mendoj, jo vetëm me thanë që do ta mbajmë 2.4 të cilin personi x e ka ngritur.

Perparim Rama-thotë se kjo është një gjë që ka ndodhur edhe ka shkuar nëpër procedura edhe ne për me e mbajt një qetësi me të involvuarit i caktojmë rregullat në bazë të cilave e zhvillon atë koeficient. Kanë më qenë në relacion me hapësirat e gjelbëra, rekreacionet po ashtu edhe rregulloret me përqindje që i dedikohen zhvillimit shoqëror, ka me pas elemente që e mbulojnë 2.4 për te mirën e vlerës shoqërore, jo të zhvillohet vetëm si metër katror.

Luan Nushi – propozon që ju keni mundësi me e propozu me Pzhk por njësinë a ka mundësi me ju thanë me e pritë Hartën Zonale.

Perparim Rama- vazhdon duke thënë se ne do të vazhdojmë me procedurat ashtu siç e parasheh ligji në fuqi, edhe nëse rrugës na dalin probleme ato mund të i zgjedhim edhe në mënyre gjyqësore mandej, edhe besoj që kish më zgjedh shumë probleme njëherë e përgjithmonë.

Prishtine 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Komiteti për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale

Datë: 12.10.2022

Nr	Emri dhe Mbiemri	E-mail dhe tel.	Nënshkrimi
1	ARBITA BYÇI JAKUPI	arbita.bychi@uni-pr.edu 049 123 248	
2	MASAR DUSHI	masardushi@gmail.com	
3	LYRA BAKIJA	lyra.bakija@rks-gov.net	
4	AFERDITA GASHI SIMANAJ	aferdita.gashi@simanaj@rks-gov.net	
5	SAMI STAGOVA	sami.stagova@un.org	
6	BESNIKE KOÇANI	besnike.kocani@un.org 044 198 563	
7	Edona Durguti	edona.durguti@rks-gov.net 069 448 277	
8	NOL BINAKAJ	nolbinakaj@gmail.com 049 344 900	
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Komiteti për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale

Datë: 12.10.2022

Nr	Emri dhe Mbiemri	E-mail dhe tel.	Nënshkrimi
1	SAMI DURAKU	sduraku@ark.org	
2	Idriz Shala	idrit.shala@gmail.com	
3	LUAN NUSLI	luan.nusli@ks-gov.net	
4	ABER SALIKI	aber.saliki@gmail.com	
5	LUMNISE GASHI	lumnisegashi8@gmail.com	
6	SADIJE DELIU	sadijed@gmail.com	
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			

